



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2817/ 2 prot.,

Datë 20.12.2022

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi operatorit ekonomikë “*ILF Consulting Engineers Austria*” GmbH & “*Abkons*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulence*” me Nr. REF-45735-10-13-2022, me objekt: “*Studimi Fizibilitetit dhe Projekt- Ide për Lidhjen Hekurudhore Durrës-Prishtinë*”, me fond limit 200,224,996 lekë pa tvsh (*dyqind milionë e dyqind e njëzet e katër mijë e nëntë qind e nëntëdhjet e gjashtë*), parashikuar për tu zhvilluar në datën 07.12.2022 nga autoriteti kontraktor, Hekurudha Shqiptare SH.A

Ankimues:

Bashkimi operatorit ekonomik “*ILF Consulting Engineers Austria*” GmbH & “*Abkons*” SHPK.

Adresa: Rruga “Themistokli Gërmenji”, Përball RTSH,
Kati II, Tiranë.

Adresa: Fledkreuzstrasse 3 6063 Rum/Innsbruck, Austri.

Autoriteti Kontraktor:

Hekurudha Shqiptare SH.A.

Adresa: Rruga “Egnatia”, Lagjia Nr.3, Durrës.

Në datën 19.12.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 2817 prot. e bashkimit të operatorit ekonomikë “*ILF Consulting Engineers Austria*” GmbH &

“Abkons” SHPK për procedurën e prokurimit “Shërbim Konsulence” me Nr. REF-45735-10-13-2022, me objekt: “Studimi Fizibilitetit dhe Projekt- Ide për Lidhjen Hekurudhore Durrës-Prishtinë”, me fond limit 200,224,996 lekë pa tvsh (dyqind milionë e dyqind e njëzet e katër mijë e nëntë qind e nëntëdhjet e gjashtë), parashikuar për tu zhvilluar në datën 07.12.2022 nga autoriteti kontraktor, Hekurudha Shqiptare SH.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorit ekonomikë ankimues “ILF Consulting Engineers Austria” GmbH & “Abkons” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:
b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që bashkimi i operatorit ekonomikë ankimues “ILF Consulting Engineers Austria” GmbH & “Abkons” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 2817 prot., datë 19.12.2022.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

- *The Economic Operator ILF Consulting Engineers Austria GmbH has presented financial sheets of 2019 and 2020 but it has not presented financial sheets of 2021 according to the standard bidding documents.*

As per above, this criterion is considered unfulfilled.

- *Operatori Ekonomik ILF Consulting Engineers Austria GmbH ka paraqitur pasqyrat financiare te vitit 2019 dhe të vitit 2020 por nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të vitit 2021 sipas kërsave dokumentave standarteve të tenderit.*

Sa me siper ky kriter konsiderohet i paplotesuar.

- *The Bidder ILF Consulting Engineers Austria GmbH has presented an invalid ISO Certificate 9001: 2015 on “Quality Management System” No. 01555/12, issued by Qualityaustria, hereby the validity period has expired on 05.11.2022.*

As per above, this criterion is considered unfulfilled.

- *Operatori Ekonomik ILF Consulting Engineers Austria GmbH, ka paraqitur ISO 9001: 2015 për “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë” me numër regjstrimi 01555/12 nga qualityaustria të pavlefshme e cila ka përfunduar afatin e vlefshmërisë me datë 05.11.2022.*

Sa me sipër ky kriter konsiderohet i paplotesuar

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 20.12.2022.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri